REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2383/7 prot Datë 06.08.2026

V E N D I M
Nr. 938/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.08.2026 me:

Objekt: 1. Vendim për pezullim procedure prokurimi.

Subjekte të interesuar: Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi 4 Heronjtë Bashkia Vlorë.

Agjencia e Prokurimit Publik.
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Operatori ekonomik BOE "Valona Konstruksion" SHPK & "Vibitis" SHPK, me NIPT K26330202E & L02103503S dhe adresë Lagjia "Uji i Ftohtë", në perëndim të Rrugës Vlorë-Orikum, në kufi me rezidencën Qeveritar,Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi informacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues,

Vëren:

Operatori ekonomik ankimues, "BOE "Valona Konstruksion" SHPK & "Vibitis" SHPK, kundërshton vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave, lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit "E hapur", me REF-83292-04-24-2026, me objekt: "Ndertimi i shkolles 9-vjecare Ismail Qemali per vitin 2026", me fond limit 298,775,474 (dyqind e nentedhjete e tetemilion e shtateqind e shtatedhjete e pesemije e katerqind e shtatedhjete e kater) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 29.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Në ankesën e tij, operatori ekonomik pretendon se anulimi i procedurës së sipërcituar të prokurimit (REF-83292-04-24-2026) pa përfunduar afatet e ankimit i ka mohuar të drejtën për paraqitjen e ankesës nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, pasi, si pasojë e anulimit të procedurës, ankesa nuk mund të paraqitej në sistem.

Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton, se procedura e mësipërme e prokurimit është hequr nga sistemi elektronik, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu nga verifikimi i kryer rezulton, se në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.47 datë 27 Korrik 2026 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e sipërcituar të prokurimit (REF-83292-04-24-2026).

Në vijim nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 24.07.2026 ka rishpalluar një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi dhe me të njëjtat të dhëna, përpara përfundimit të afateve të ankimimit, sikurse përcaktohet në nenin 110, pika 2 të LPP. Procedura e rishpalluar nga autoriteti kontraktor ka këto të dhëna: "E hapur", me REF-94239-07-22-2026, me objekt: "Ndertimi i shkolles 9-vjecare Ismail Qemali per vitin 2026", me fond limit 298,775,474 (dyqind e nentedhjete e tetemilion e shtateqind e shtatedhjete e pesemije e katerqind e shtatedhjete e kater) lekë pa tvsh, planifikuar për tu zhvilluar në datën 10.08.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë. Nga verifikimi i kryer, në njoftimin e kontratës, të procedurës së prokurimit të rishpalluar (REF-94239-07-22-2026), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar në pikën 9 "*Procedurë e Rishpallur*", numrin e referencës, objektin e prokurimit, si dhe fondin limit të procedurës së anuluar të prokurimit.

Operatori ekonomik ankimues "BOE "Valona Konstruksion" SHPK & "Vibitis" SHPK, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën me objekt "*Kërkesë për pezullimin e procedures së prokurimit me REF-94239-07-22-2026 të ripublikuar më datë 23.07.2026 me të njëjtin objekt "Ndertimi i shkolles 9-vjecare Ismail Qemali per vitin 2026",* protokolluar me tonën me nr.2383/5 prot., datë 06.08.2026, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik me kërkesë për pezullimin e procedurës me Nr. REF-94239-07-22-2026, të ripublikuar nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Nenit 29 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, në të cilin parashikohet: "*1.Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.* ***2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.*** Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit "E hapur", me REF-94239-07-22-2026, me objekt: "Ndertimi i shkolles 9-vjecare Ismail Qemali per vitin 2026", me fond limit 298,775,474 (dyqind e nentedhjete e tetemilion e shtateqind e shtatedhjete e pesemije e katerqind e shtatedhjete e kater) lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar në datën 10.08.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë, moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	**Anëtar**	**Anëtar**
Gjergj Mersini	**Nertil Kanina**	**Edvin Simo**

Kryetar
Ismail Shehu

Ismail Shehu
Digitally signed by Ismail Shehu
Date: 2026.08.06 13:50:45 +02'00'